

FAQ – Scuola dell’Infanzia comunale FAQ - Kopsht komunal

Si mund të regjistroni fëmijën tuaj në kopsht komunal? (Si dhe kur mund të bëni kërkesën për regjistrim?)

Kërkesa për regjistrim në kopshtin komunal bëhet vetëm në periudhën kur hapet regjistrimi on-line, nëpërmjet faqes së internetit <https://servizi.055055.it/iscrizionematernefe/>.

Periudha e regjistrimit e cila vendoset me anë të një njoftimi të Drejtorisë së Arsimimit, duke ndjekur njoftimin me të njëjtin subjekt të Ministrisë së Arsimit qëllon zakonisht me periudhën Janar/Shkurt të vitit kur fëmija do fillojë të ndjekë shkollën (në shtator).

Është i mundur regjistrimi në më shumë kopshte?

Jo, m.gj.th mundet të zgjidhet një kopsht i dytë si alternativë, i dobishm në rast se kërkesa në kopshtin e parë nuk pranohet për shkak të mungesës së vendeve. Si alternativë mund të zgjidhen kopshte komunale dhe shtetërore duke patur parasysh se sistemi informatik është i njëjti. Këshillohet të zgjidhet kopshti që ndodhet afër zonës së banesës për të përfitur sa më shumë pikë në listë.

Në çfarë mënyre mund të njohë kopshtin që ndodhet afër zonës sime?

Duke vizituar faqen e internetit të Komunës së Firences në këtë adresë: <https://www.comune.fi.it/servizi/cercascuola> dhe duke shtypur në “motore di ricerca scuole di appartenenza”.

Kur mund të di nëse kërkesa e regjistrimit është pranuar?

Lista e regjistrimeve publikohet në përgjithësi midis muajit Maj/Prill dhe mund të kontrollohet në sitin e Komunës së Firences <https://educazione.comune.fi.it/> ose në shkollat e përzgjedhura.

Në rast se kërkesa nuk është pranuar nga kopshti, çfarë duhet të bëjë familja?

Është e mundur të bëhet një kërkesë e re për një kopsht tjetër, edhe mbas skadencës së kohës së parashikuar për regjistrim, sepse brenda muajit Korrik aprovohet një listë e dytë e cila mund të përdoret për vendet e lira në dispozicion. Për të aplikuar këtë procedurë është i domosdoshëm anulimi i kërkesës së parë.

Kush është kalendari shkollor?

Kalendari shkollor vendoset nga Rajoni i Toskanës, për të gjitha shkollat në territor.

Kush është orari javor i kopshteve?

Zakonisht orari normal është 8:30 me 16:30, nga e hëna në të premte, por mund të zgjidhet dhe një orar i reduktuar, 8:30 me 12:30, nga e hëna në të premte.

Zgjedhja e orarit që në fillim të vitit është i rëndësishëm?

Po

Është e parashikuar hyrja përpara orarit normal?

Po, është e parashikuar duke bërë një kërkesë në momentin e regjistrimit që të kërkoet hyrja përpara kohe, nga ora 7:30 ose nga ora 8:00.

Ky shërbim aktivizohet vetëm në bazë të një numri kërkesash minimale.

Është e parashikuar dalja më vonë orarit normal?

Po, është e parashikuar duke bërë një kërkesë në momentin e regjistrimit që të kërkoet dalja në orën 17:00.

Ky shërbim aktivizohet vetëm në bazë të një numri kërkesash minimale.

Si mund të kërkoet dalja para orarit normal?

Daljet para orarit normal nuk duhet të jenë të shpeshta dhe duhet të jenë të motivuara.

Megjithatë, me anë të një formulari që i kërkoet edukatoreve, mund të bëhet një kërkesë e veçantë për daljet parakohe, për t'i dhënë mundësinë fëmijëve të marrin pjesë në aktivitetet jashtëshkollore (si për shembull: në sport, muzikë, balet, etj...).

Është i mundur gjumi i drekës për fëmijët në kopsht?

Në kopsht nuk është e parashikuar koha e gjumit.

M.g.j.t, mbas drekës, janë të parashikuara momente për çplodhje dhe pushim.

Kush merret me ushqimin?

Zyra Shërbimi i Ushqimit shkollor i Drejtorisë së Arsimit– email: refezione.controlliquality@comune.fi.it. Mënyja mund të konsultohet në faqen e internetit të çdo shkolle <https://educazione.comune.fi.it/pagina/mensa> ose duke shkarkuar APP nga faqja e internetit <https://ugalatartarugaconlavela.it/il-mio-calendario/>

Kush ndihmon fëmijët gjatë drekës?

Edhe rutina e ngrënies konsiderohet si një moment edukues, dhe kjo është arsyeja për të cilën personeli i kopshtit dhe edukatorët ndihmojnë fëmijët dhe janë të pranishëm gjatë drekës. Gjithashtu, është prezent edhe personeli i mensës që ndihmon në ndarjen e pjatave.

Për fëmijët e regjistruar në kopshte, është automatike dhe regjistrimi në shërbimin e mensës?

Jo, duhet plotësuar formulari i ushqimit, nëse zgjidhet shërbimi me kohë të plotë (orari normal 8:30 me 16:30).

Kujt duhet t'i drejtoheni për çdo gjë lidhur me mensën, si në përgjithësi apo në raste kërkesash të veçanta, për motive shëndetësore ose fetare?

Janë të mundura ndryshime të menus (të ekspozuara në çdo shkollë) në rast alergjie ose intolerance (të vërtetuara nga çertifikata mjekësore) ose për motive etike dhe fetare (shërben një autoçertifikatë). Kërkesa duhet bërë në momentin e regjistrimit, duke përjashtuar rastet kur problemet shfaqen gjatë vitit shkollor. Formularët mund të shkarkohen nga faqja e internetit: <https://educazione.comune.fi.it/pagina/mensa> dhe duhen dorëzuar edukatoreve të cilat e transmetojnë mensës. Është e mundur gjithashtu, të kërkohet për jo më shumë se tri ditë në muaj një vakt “i bardh” (in bianco), në prani të shqetësimeve gastrointestinale pa patur nevojë të vërtetohet nga çertifikata mjekësore. Nëse kjo kërkesë është për më shumë se tri ditë nevojitet çertifikata mjekësore.

Kush janë gjërat që fëmijët duhet të kenë gjithmonë me vete?

Këshillohet që fëmijët të vishen në mënyrë praktike dhe komode (për shembull me tuta, këpucë që mbyllen me ngjitse, jo lidhëse, etj...) dhe me rroba që mund të bëhen pis si me ngjyra apo ngjitëse.

Në shkollë duhet të lihet për raste nevoje, një çantë stofi ose kuti me një palë ndërresa (të brëndshme, një bluzë, një palë tuta, një palë këpucë) dhe duhen kontrolluar sipas ndërrimit të stinëve.

Në çantën e përditëshme të fëmijës, që duhet kontrolluar çdo ditë, duhet vënë një gotë plastike, një picet dhe një gushore. Në të gjitha rrobat dhe sendet e fëmijës duhet shënuar emri i/e tij/saj.

Fëmija vesh përparëse?

Nuk ka një rregull universal për të gjitha shkollat. Ka disa shkolla në të cilat përparësja kërkohet dhe në disa të tjera që nuk kërkohet. Kuminikimi për këtë gjë bëhet nga edukatorët në mbledhjen e parë me familjet e fëmijëve të sapo regjistruar.

Pranohen në shkollë fëmijë të cilët nuk janë akoma autonomë në përdorimin e shërbimeve igjenike, ose më mirë ata të cilët përdorin akoma panolinon?

Po, edhe pse preferohet që fëmijët të kenë arritur një autonomi të kënaqshme.

Kush merret me higjenën e shkollës?

Personeli E.S.E (Esecutori Servizi educativi) dhe operatorët e jashtëm, të cilët ndjekin protokolle të veçanta për pastrimin dhe mbajtjen rregullt të ambjenteve.

Ka një protokoll të veçant për rastin kur shfaqen parazitë?

Po: egzistojnë këshilla specifike nga ASL përsa i përket sjelljes që duhet të mbajnë edukatorët dhe prindërit në rastin kur shfaqen parazitët. Këshillohet të kontrollohen rregullisht kokat e fëmijëve për të verifikuar n.q.f kanë thërriza ose morra, dhe në rast pozitiv, duhen njoftuar menjëherë edukatorët të cilat do t'ju këshillojnë çfarë duhet të bëni në këto raste.

Si mund të bëhet kërkesa për mësimin e fesë katolike?

Në momentin e regjistrimit të fëmijës në kopsht, familja mund të zgjedhë për mësimin e fesë katolike apo jo, për gjithë vitin shkollor.

Për fëmijët të cilët familjet nuk kanë bërë këtë kërkesë janë të parashikuara aktivitete alternative.

Çfarë është P.T.O.F. (Piano Triennale dell'Offerta Formativa)?

Është Plani trevjeçar i Ofertës shkollore, dokument i cili sjell identitetin kulturor dhe projekin e çdo kopshti, i hartuar në mënyrë autonome për sa i përket didaktikës duke u bazuar në udhëzimet kombëtare për Planin Arsimor, të parashikuara nga MIUR (Ministria e Arsimit) dhe udhëzimet e Shërbimi Shërbimet për Fëmijët (Servizio Servizi all'Infanzia) i Komunës së Firences.

Ky dokument parashikon aktivitete si: pritja, shoqërimi, mos diskriminimi, vazhdimësia edukative, raporti me territorin, dokumentimi i aktiviteteve.

Mund të zgjidhet grupi (klasa) në momentin e regjistrimit?

Jo, sepse regjistrimi bëhet për shkollën dhe jo për grupin (klasën).

Kush janë kriteret e formimit të grupeve?

Kolegji i Mësuesve i çdo kopshti vendos për formimin e grupeve në bazë të kriterëve të udhëzuara nga Komunikata e Regjistrimeve (Circolare per le Iscrizioni) dhe të vendosura nga Shërbimi, që janë: ekuilibër numerik duke patur parasysh tri fashat e moshës, gjinisë, nënshtetisë, dhe situatave të vështira në familje.

Kam dy fëmije të cilët duhet t'i regjistroj në kopsht, është e mundur të futen në të njëjtin grup?

Jo, për të favorizuar dhe rritur autonomi personale, kuptimin e qytetarizimit dhe formimit të identitetit, në momentin e formimit të grupeve, fëmijët që i përkasin të njëjtës familje futen në grupe të ndryshme.

Si dhe kur mund të njihet formimi i grupeve?

Lista e grupeve bëhet publike në çdo shkollë në Shtator.

Kush janë momentet e parashikuara dhe të shënuara në kalendar, të komunikimit midis kopshtit dhe familjes?

- Mbledhje me prindërit e fëmijëve të rinj të regjistruar: bëhet në fund të Qeshorit ose në fillim të Shtatorit para fillimit vitit shkollor, kjo varet nga zgjedhja individuale që bën çdo kopsht.
- Prezantimi i P.T.O.F. (Piano Triennale dell'Offerta Formativa): bëhet midis Tetorit dhe Nëntorit për të shpjeguar familjeve Planin Edukativ të Kopshtit, i cili i përket vitit në vijim.
- Mbledhje individuale me prindin: është e garantuar të paktën një herë në vit për çdo familje, megjithatë, edukatorët janë të disponueshme edhe për mbledhje të tjera në rast kërkesë nga familja, dhe kur edukatorët e shohin të arsyeshme.
- Mbledhje prindërisht: takime midis prindërve dhe edukatoreve në çdo grup.
- Përfaqësues i prindërve të grupit dhe të kopshtit: gjatë mbledhjeve me prindërit, këta të fundit zgjedhin një përfaqësues të grupit dhe një të kopshtit, në mënyrë që komunikimet midis kopshtit dhe familjeve të jenë sa më të mira.
- Verifikimi i P.T.O.F.: bëhet në fund të vitit shkollor për të verifikuar së bashku me familjet sa është arritur ky plan më anë të Projektit Edukativ të Shkollës.

Është e mundur të kërkohet dhënia e ilaçeve nga ana e personelit të kopshtit?

Në rast kur fëmija duhet të marrë ilaçe të cilat i shpëtojnë jetën ose janë të domosdoshme gjatë orarit të kopshtit, duhet që familja të prezantojë një certifikatë mjekësore dhe të autorizojë me anë të një formulari të veçantë edukatorët.

Mbas sa ditë mungese në kopsht duhet të çohet certifikata mjekësore?

Për të ripranuar fëmijën në shkollë mbas një sëmundjeje me një mungesë mbi pesë ditë është e nevojshme certifikata mjekësore (për kthimin në shkollë në ditën e gjashtë nuk është e nevojshme certifikata); ditët e festave (e shtunë apo e dielë) llogariten vetëm në rast se i bashkohen ditëve të sëmundjes (për shembull: 1. kur fillon mungesa të premtën, rikthimi në shkollë deri të mërkurën e ardhshme nuk ka nevojë për certifikatë, nga e enjtja e ardhshme dhe më pas po; 2. fillon mungesa të hënën, për kthimin në shkollë të hënën e ardhshme nuk ka nevojë për certifikatë, nga e marta e ardhshme po).

Në rast kur fëmija është me allçi, qepje dhe mjekime të tjera, është e mundur të pranohet në shkollë me një deklaratë të nënshkruar nga prindërit.

PËR TË QËNË GJTHMONË TË PËRDITËSUAR VIZITONI SITIN E INTERNETIT

<https://educazione.comune.fi.it/pagina/0-6-anni/3-6-anni>